

VENDIM

Nr.133, datë 15.2.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.150, DATË 18.3.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E MADHËSISË SË PAKETËS SË AKSIONEVE TË KAPITALIT TË ARMO SHA-SË, QË U OFROHET PËR SHITJE INVESTITORËVE STRATEGJIKË”, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.82, DATË 3.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E INSTRUKSIONEVE PËR PARAQITJEN, HAPJEN DHE VLERËSIMIN E OFERTAVE PËR PRIVATIZIMIN E ARMO SHA-SË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, dhe të neneve 7 e 8 të ligjit nr.9117, datë 24.7.2003 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të “ARMO” sh.a., Fier”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- I. Pika 1 e vendimit nr.150, datë 18.3.2005 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
- II. Në vendimin nr.82, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:
 1. Në shtojcën 1, që i bashkëlidhet vendimit, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në kapitullin I “Përkufizime”, paragrafi “Aksione”, ndryshohet si më poshtë vijon:

““Aksione” do të thotë 5 357 725 (pesë milionë e treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) aksione nominative të ARMO-s, me një vlerë nominale prej 1 000 (një mijë) lekësh secili, plotësisht të paguara, që i korrespondojnë 85 për qind të kapitalit të “ARMO-s”, të cilat u janë ofruar kandidatëve.”.
 - b) Në pikën 2.1, të kapitullit II, “Të përgjithshme”, të bëhen këto ndryshime:
 - i) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Të jetë shoqëri e specializuar në fushën e përpunimit e të tregtimit të naftës/gazit e nënprodukteve të tyre, që t’i ketë ushtruar këto veprimtari për jo më pak se tre vjet”.

ii) Nënndarja “i” e shkronjës “d”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i) Investitori strategjik duhet të zotërojë të paktën 20 për qind të kapitalit dhe të së drejtës së votës në shoqërinë e përbashkët;”.

2. Në shtojcën 3, që i bashkëlidhet vendimit, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1 “Teknik”, numri “40” bëhet “25”;

b) Në pikën 3 “Aspekti financiar”, numri “60” bëhet “75”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha